



REPUBLIKA E KOSOVËS
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
Sekretariati / Sekretarijat / Secretariat

KOMUNA E LIPJANIT
OPËSTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA LIPJAN
REPUBLIKA KOSOVO
OPËSTINA LIPLJAN

01 Nr.Br. 113-36643

Data/Datum 06.07.2021

**Marrëveshje Bashkëpunimi
mes
Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (SKGJK)
dhe
Komunës së Lipjanit – Kryetarit z.Imri Ahmeti**

Lidhur me këtë marrëveshje Bashkëpunimi sipas dispozitave në vijim:

**Neni 1
Qëllimi**

1. Qëllimi i kësaj marrëveshje të bashkëpunimit (më tutje: marrëveshja), ndërmjet Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (më tutje: SKGJK) dhe Komunës së Lipjanit është realizimi i pagesës mujore prej 100 € për secilin praktikant për periudhën 6 mujore nga data 01.07.2021 e deri më 31.12.2021.
2. Praktika në punë i'u ndihmon pjesëmarrësve mundësinë e fitimit të përvojës së nevojshme për të filluar karrierën në fushën e drejtësisë.

**Neni 2
Fushëveprimi**

1. Kjo marrëveshje bashkëpunimi përcakton termet dhe kushtet e bashkëpunimit në mes të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor (KGJK) dhe Komunës së Lipjanit, në zhvillimin-realizimin e praktikës në punë për 16 (gjashtëmbëdhjetë) praktikantë në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Dega Lipjan.
2. Projekti i aktivitetit si në nenin 1 të Marrëveshjes do të angazhoj 16 (gjashtëmbëdhjetë) praktikantë me mbështetje financiare mujore me nga 100 € (njëqindë euro), të cilët janë të punësuar si praktikant në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Dega Lipjan, sipas Aktemrimeve përkatëse te dates 23.02.2021.
3. Kësaj marrëveshje do t'i bashkangjiten Aktet e Emërimeve të 16 (gjashtëmbëdhjetë) praktikantëve që janë të angazhuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë-Dega Lipjan.

Neni 3
Obligimet e Komunës së Lipjanit

1. Të siguroj mjetet financiare në vlerë prej 100 € (njëqindë euro) në muaj për 16 (gjashtëmbëdhjetë) praktikantë periudhën 6 (gjashtë) mujore, shuma e përgjithshme e vlerës është 9.600€ (nëntë mijë e gjashtëqind euro).
2. Kompenzimi i pagesës për 16 (gjashtëmbëdhjetë) praktikantë në vlerë prej 100 € (njëqindë euro) në muaj do të bëhet në xhirrollogaritë bankare të praktikantëve që vijnë praktikën në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Dega Lipjan
3. Komuna e Lipjanit nuk është përgjegjëse për ndonjë shpenzim apo ndonjë dëmtim të paisjeve në punë, shpenzimet nga aksindetet apo sëmundjet e pjesëmarrësve gjatë praktikës në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Dega Lipjan

Neni 4
Obligimet e Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës

1. Sekretariati, përkatësisht Gjykata Themelore në Prishtinë-Dega Lipjan bashkëpunon me Komunën e Lipjanit për të mundësuar realizimin kësaj marrëveshje.
2. Sekretariati, përkatësisht Gjykata Themelore në Prishtinë-Dega Lipjan pajtohet që gjatë praktikës do të sigurojë një mjedis të sigurt në punë në përputhje me legjislacionin në fuqi.
3. Sekretariati, përkatësisht Gjykata Themelore në Prishtinë-Dega Lipjan do të dorëzon në Komunën e Lipjanit ka një kopje të Akt Emërimeve të 16 praktikantve menjëher pas nënshkrimit të kësaj marrëveshje
4. Në rast që Sekretariati ndërpretë kontratat me praktikantet e angazhuar në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Dega Lipjan gjatë periudhës sa është në fuqi kjo marrëveshje atëherë merr obligim që ta informojë menjëherë Komunën e Lipjanit.

Neni 5
Kohëzgjatja

Kjo marrëveshje lidhet për kohë të caktuar për periudhën 6 (gjashtë) mujore duke filluar nga data 01.07.2021 deri me datë 31.12.2021.

Neni 6
Implikimet Financiare

1. Palët kontraktuese janë pajtuar që komplet financimin e këtij projekti ta bëjë Komuna e Lipjanit për 16 (gjashtëmbëdhjetë) praktikantë me mbështetje financiare mujore me nga 100 € (njëqindë euro), shuma e përgjithshme prej 9.600€ (nëntë mijë e gjashtëqind euro).
2. Kjo marrëveshje nuk ka implikime financiare për Sekretariatit dhe gjykatat.

Neni 7
Hyrja në fuqi

1. Marrëveshja hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.
2. Kjo Marrëveshje është hartuar në dy (2) kopje identike origjinale dhe secila nga palët marrin nga një (1) kopje.


Shkëlzen Maliqi

Drejtore i Përgjithshëm i SKGJK


Amri Ahmeti

Kryetari i Komunës së Lipjanit